VENDIM
Nr.716, datë 2.9.2010

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.346, DATË 12.5.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË DISA MJEDISEVE, NGA KËSHILLI I MINISTRAVE TEK AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1058, DATË 16.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja "c" të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.346, datë 12.5.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

a) Në pikën 1, pas fjalëve "…. një pjesë e katit të parë…" shtohen "…, përfshirë edhe garazhet ngjitur pas kësaj pjese të katit të parë, si…";

b) Bashkëlidhur vendimit në fuqi shtohet edhe planimetria që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Kryeministria, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Agjencia e Aviacionit Civil dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLAN-RILEVIMI I PARKUT TE DELEGACIONEVE

SHK. 1:500



LEGJENDA

KUFIRI I PRONES

SIPERFAQJA TOTALE E TRUALLIT S=5301M²

SIPERFAQJA TOTALE E NDERTIMIT S=2755M²

GARAZHET E VJETRA (EKSISTUES) IKAT S=1987M²

ZYRAT E VJETRA TE PARKUT TE DELEGACIONEVE IKA
S=193M²+148M²+43M²(DERA HYRESE,TUNELI)=384M²

PORTA HYRESE (TUNELI) S=43M²

PUNOI: ING. GEZIM HASKO

NR. LIÇ. T 0041/4

TIRANE, 28.07.2010